REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. KGJK,nr.97/2016
DAT.DT. 30 gusht 2016
PRISHTINË - A

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 05/L -033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 161-të, të mbajtur me 30 gusht 2016, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja (11/2016) për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nehat Idrizi,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Kryetarëve të gjykatave*
- *Sekretariatit të KGJK-së*
- *Arkivit*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 273
14. 09. 2016
PRISHTINË - A

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duke u bazuar në nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 19 të Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr.5/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 161-të, mbajtur me datë 30 gusht 2016 miraton këtë

RREGULLORE 11/2016

PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQTARËVE

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton kriteret dhe rregullat lidhur me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe përbën bazë për ngritje apo ulje në detyrë, përfshirë shkarkimin e gjyqtari dhe për qëllim të ri-emërimit, si dhe përbërjen dhe mandatin e komisionit të vlerësimit.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që përmes vlerësimit të synohet ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe gjyqtarëve në veçanti duke krijuar mekanizma që sigurojnë një sistem transparent të llogaridhënies.

3. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë gjyqtarët e gjykatave të Kosovës përjashtimisht për gjyqtarët porotë dhe kryetarët e gjykatave vlerësimi i të cilëve do të rregullohet më rregullore të veçantë.

Neni 2
Përkufizimet

1. Komisioni për vlerësim nënkupton Komisioni përgjegjës për vlerësimin e performancës se gjyqtarëve. të përberë nga trembdhjetë (13) antarë të përzgjedhur nga anëtarët e KGJK-së.

2. Nën komisioni për vlerësim nënkupton anëtaret e Komisionit për Vlerësim i përbërë nga tre (3) anëtarë të Komisionit për Vlerësim nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.

3. Anëtari raportues i komisionit nënkupton një (1) anëtar të Komisionit për Vlerësim i cili është përgjegjës për mbledhjen e informatave lidhur më vlerësimin e gjyqtarëve sipas planit vjetor te punës.

4. Trajnues nënkupton ligjëruesin e pjesës teorike të programit fillestar i caktuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.

5. Mentori nënkupton gjyqtarin e caktuar nga KGJK për pjesën praktike të programit fillestar. Mentori mund të caktohet gjyqtari i cili ka mandat të përhershëm, së paku pesë (5) vite përvoje pune dhe nuk ka masa disiplinore të shqiptuara ndaj tij.

Neni 3
Parimet e vlerësimit

1. Vlerësimi i gjyqtarëve bëhet në pajtim me parimin e ligjshmërisë, barazisë, objektivitetit, transparencës dhe garantimit të mundësive të barabarta dhe të drejta për zhvillimin e karrierës së gjyqtarit.

2. Vlerësimi nuk ka për qëllim ndërhyrjen në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarit.

Neni 4
Periudha e vlerësimit

1. Gjyqtarët me mandat fillestar vlerësohen dy (2) herë përgjatë këtij mandati dhe atë një herë pas trajnimit fillestar dhe një herë para skadimit të mandatit fillestar me qëllim të riemërimit.

2. Gjyqtarët me mandat të përhershëm vlerësohen çdo tri (3) vjet.

Neni 5
Shkallët e vlerësimit

1. Gjyqtarët vlerësohen sipas shkallëve në vijim prej 1 deri në 100 pikë, dhe atë:
   - 1.1 prej 1 deri në 30 pikë vlerësohet me vlerësimin "dobët";
   - 1.2 prej 31 deri në 50 pikë vlerësohet me vlerësimin "mirë";
   - 1.3 prej 51 deri në 80 pikë, vlerësohet me vlerësimin "shumë mirë"; dhe
   - 1.4 mbi 81 pikë vlerësohet me vlerësimin "shkëlqyeshëm".

2. Vetëm gjyqtarët që vlerësohen me vlerësimin "shkëlqyeshëm" do të mirën në konsiderim për ngritje në detyrë në rast të pozitave vakante në Gjykatën e Apelit dhe/ose Supreme. Në rast se vlerësimi rezulton se nuk ka mjaftueshëm gjyqtarë të ranguar sipas pikëve me vlerësim "shkëlqyeshëm", KGJK merr në konsiderim gjyqtarët e ranguar sipas pikëve me vlerësimin "shumë mirë".

3. Komisioni për vlerësim do të përpilojë një Udhëzues për vlerësimin e gjyqtarëve me pikë minimale dhe maksimale për secilin indikator i cili do të bëhet publik për gjyqtaret para së të fillojë procesi i vlerësimit.

KREU II

VLERËSIMI I GJYQTARËVE ME MANDAT FILLESTAR

Neni 6
Kriteret e vlerësimit dhe burimet e informacionit

1. Përgjatë vijimit të trajnimit fillestar, gjyqtarët me mandat fillestar vlerësohen në fund të trajnimit fillestar 12 mujor, dhe vlerësimi i tyre bëhet dukë marrë për bazë njohuritë e fituara përgjatë trajnimit në pjesën teorike dhe atë praktike.

2. Vlerësimi i gjyqtarëve me mandat fillestar bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës duke marrë për bazë raportet e trajnuesve dhe mentorëve dhe bëhet përshtatshmërisht sipas kritereve të vlerësimit për gjyqtarët më mandat të përhershëm, aq sa ato janë të aplikueshme.

3. Raporti i pjesës teorike përpilohet nga trajnuesit. Secili trajnues i cili është përgjegjës për modul të caktuar është përgjegjës për përpilimin e raportit të veçantë për secilin gjyqtar. Mostra e raportit si Shtojcë 1 e kësaj rregullore do të shfrytëzohet nga trajnuesit.

4. Raporti i pjesës praktike bëhet nga mentorët përkatës të caktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në secilën gjykatë sipas shpërndarjes së bërë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës varësisht rezultateve të tyre përgjatë procesit të rekrutimit. Mostra e raportit në Shtojcën 2 të kësaj rregullore do të shfrytëzohet nga mentorët.

5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përkatësisht Komisioni për vlerësimin e performancës përpilon raport uniform mbi bazën raportit nga trajnuesi (pjesa teorike) dhe mentori (pjesa praktike) e gjyqtarëve me mandat fillestar.

6. Nëse gjykatësi me mandat fillestar dështon te përfundoj trajnimin ne mënyrë adekuate ashtu siç është vlerësuar sipas raportit te mentorit dhe trajnuesit, Komisioni mund të rekomandoj vazhdimin e trajnimit fillestar edhe për më së shumti tre (3) muaj.

7. Nëse gjykatësi me mandat fillestar pranon një raport negativ nga mentori dhe trajnuesi në fund te trajnimit fillestar dhe si rrjedhojë merr vlerësimin negativ edhe nga komisioni, i njëjti propozohet për shkarkim.

Neni 7
Raporti nga ana e trajnuesit

1. Trajnuesi gjatë përpilimit të raportit për gjyqtarin e caktuar, dëshmon për rezultatet e treguara gjatë pjesës teorike që përmban: të dhëna për punën individuale, grupore, aftësi për zgjidhjen e çështjeve, analiza ligjore gjatë hartimit të akteve, dhe aftësitë komunikuese.

2. Pas përpilimi të raportit, gjyqtari ka të drejtë të shikojë raportin dhe të jap ndonjë koment apo vërejtje, në ç 'rast behët pjesë integrale e raportit.

3. Raporti i trajnuesit vendoset në një pliko të mbyllur dhe i dorëzohet Komisionit për Vlerësimin e Performancës.

Neni 8
Vlerësimi nga ana e mentorit

1. Raporti i përpiluar përmban të dhëna në lidhje me cilësinë e punës, analizën e rasteve praktike, shkathtësitë ndër personale, pavarësia dhe fleksibiliteti, udhëheqja, iniciativa, etika, komunikimi dhe shkathtësitë analitike, shkathtësitë shtesë (kompjuterike, gjuhët, organizative, etj.) dhe vijueshmërinë.

2. Pas përpilimi të raportit, gjyqtari ka të drejtë të shikojë raportin dhe të jap ndonjë koment apo vërejtje, në ç 'rast behët pjesë integrale e raportit.

3. Raporti i mentorit vendoset në një pliko të mbyllur dhe i dorëzohet Komisionit për Vlerësimin e Performancës.

Neni 9
Vlerësimi përfundimtar i trajnimit fillestar

1. Pas pranimit të raporteve nga trajnuesi dhe mentori përfshirë edhe komentet e gjyqtarit, Komisioni për Vlerësimin e Performancës bazuar në këto raporte vlerëson performancën e gjyqtarit.

2. Vlerësimi i kryer nga Komisioni përbën bazë për fillimin e funksionit të gjyqtarit, përkatësisht caktimin e rasteve siç përcaktohet me nenin 27, parag. 2 të Ligjit për Gjykata.

Neni 10
Vlerësimi i gjyqtarëve për qëllim të ri-emërimit

1. Jo më vonë se tre (3) muaj para skadimit të mandatit fillestar Komisioni për Vlerësimin e Performancës bën vlerësimin e dytë të gjyqtarëve.

2. Kriteret e përcaktuara për vlerësimin e gjyqtarëve me mandat të përhershëm sipas Kreut III të kësaj Rregulloreje zbatohen përshtatshmërisht për këtë vlerësim.

3. KGJK merr vendim mbi vlerësimin e gjyqtarit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të raportit nga Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

4. Vendimet e gjyqtarëve të vlerësuar për qëllim të ri-emërimit të përhershëm i dërgohen Presidentit të Republikës së Kosovës se bashku me emrat e propozuar për emërim, më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të mandatit fillestar.

KREU III

VLERËSIMI I GJYQTARËVE ME MANDAT TË PËRHERSHËM

Neni 11
Përzgjedhja me short

1. Gjyqtarët me mandat të përhershëm vlerësohen sipas radhës së përcaktuar përmes metodës së shortit.

2. Para fillimit të secilit vit kalendarik, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga lista e përgjithshme e gjyqtarëve të radhitur sipas gjykatave në EXCEL përmes komandës "RANDOM" përzgjidhen 1/3 e gjyqtarëve të cilët do të i nënshtrohen vlerësimit në vitin vijues.

Neni 12
Kriteret e vlerësimit

1. Kriteret e vlerësimit të përcaktuara me nenin 19 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, janë si në vijim:

1.1. njohurinë profesionale, kapaciteti për arsyetime ligjore, aftësinë dhe kapacitetin në analizimin e problemeve ligjore dhe aftësinë profesionale bazuar në rezultat e karrierës së mëparshme, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performanca;

1.2. performancën;

1.3. përvojën e punës;

1.4. të njohurit dhe respektimin e të drejtave të njeriut;

1.5. sjelljen jashtë zyrës, integritetin personal dhe aftësinë për të kryer detyrat e zyrës në mënyrë të paanshme, të vetëdijshme, të zellshme, të vendosur dhe të përgjegjshme; dhe

1.6. aftësitë komunikuese.

Neni 13
Treguesit matës të kritereve për vlerësim

1. Kriteri i përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.1 matët sipas treguesve në vijim:
   1.1. përmes cilësisë së vendimeve gjyqësore
   1.2. arsyetimi i vendimit
   1.3. analiza e provave
   1.4. pjesëmarrja në trajnime
   1.5. numri i lëndëve të vendosura në procedurë ankimore,
   1.6. aktiviteti shkencor dhe akademik.

2. Kriteri i përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.2 matet sipas treguesve në vijim:
   2.1. menaxhimi efikas i lëndëve,
   2.2. trajtimi i lëndëve sipas radhës (arritjes),
   2.3. koha e shqyrtimit te lëndës (standardi kohor),
   2.4. përpilimit i vendimit gjyqësor brenda afatit kohor,
   2.5. aftësitë dhe sjelljet gjatë udhëheqjes së seancës,
   2.6. mirëmbajtja e dosjes gjyqësore,
   2.7. përdorimi i SMIL (nëse është në përdorim),
   2.8. kontributi në komunitet (vizite na shkolla, tek komunitetet vulnerabil, OJQ, etj.).

3. Kriteri i përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.3 matet sipas viteve të kaluara si gjyqtar në departamentin përkatës.

4. Kriteri i përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.4 matet sipas treguesve ne vijim:
   4.1 zbatimi në raste praktike i konventave ndërkombëtare të aplikueshme
   4.2 referimi i vendimeve gjyqësorë në aktgjykimet e GjEDNj.

5. Kriteri i përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.5 matet sipas treguesve në vijim:
   5.1 numri i vendimeve të KD dhe/ose KGjK
   5.2 vendimmarrje transparente
   5.3 ballafaqimi me vendime të domosdoshme
   5.4 debatimi dhe kritika konkrete

6. Kriteri i përcaktuar në nenin 12, paragrafi 1, nën-paragrafin 1.6 matet sipas treguesve në vijim:

   6.1 të dëgjuarit aktiv i palëve dhe te tjerëve dhe
   6.2 shkëmbimi i përvojave.

7. Indikatorët e matshëm të kritereve të vlerësimit të përcaktuara në këtë nen do të zbatohen në mënyrë të barabartë për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, me përjashtim të nën paragrafëve 1.1.1, 1.1.2, dhe 1.1.3 të paragrafit 1 dhe pika 6.1. të paragrafit 6.

Neni 14
Burimet e Informacionit

1. Burimet e informacionit që përdoren për vlerësimin e gjyqtarëve më mandat të përhershëm janë:

1.1. dosja personale e gjyqtarit;

1.2. raporti i kryetarit të gjykatës;

1.3. vendimet e zgjedhura nga anëtari raportues i Komisionit sipas vendimit për përcaktimin e numrit për përzgjedhjen e rastësishme të vendimeve gjyqësore për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve siç është paraparë në nenin 28 të kësaj rregulloreje;

1.4. vendimet e dorëzuara nga gjyqtari;

1.5. vërejtjet eventuale të gjyqtarit;

1.6. statistikat;

1.7. raporti i anëtarit raportues i Komisionit nga monitorimi i seancave dhe aktiviteteve trajnuese;

1.8 intervistat eventuale me gjyqtarin;

1.9. vendimet disiplinore;

1.10. çfarëdo dokumenti tjetër që përmban informacione objektive dhe relevante lidhur me aktivitetet profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në aktivitetet profesionale të gjyqtarit.

2. Burimet e informacionit të parapara në këtë nen kufizohen vetëm në indikatorë të matshëm që janë të zbatueshëm për gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

KREU IV

VLERËSIMI I INFORMATAVE STATISTIKORE

Neni 15
Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve

1. Efikasiteti dhe koha e zgjidhjes së lëndëve vlerësohet duke analizuar:
   1.1 suksesin e gjyqtarit në realizmin dhe tejkalimin e normës për lëndët e zgjidhura (procesuara);

1.2 krahasimi i numrit te lëndëve te zgjidhura nga ana e gjyqtarit me mesataren e lëndëve të zgjidhura nga gjykata përkatëse duke përfshirë natyrën e rastit;
1.3 krahasimi i numrit të lëndëve të grumbulluara të gjyqtarit përkatës me mesataren e numrit te grumbulluar të gjykatës përkatëse; dhe
1.4 kompleksitetit i lëndëve.

2. Faktorët tjerë që duhet të merren parasysh, përfshijnë:
2.1 mungesa në pune për shkak te festave, trajnimeve etj.;
2.2 nuk ka numër të mjaftueshëm të lëndëve;
2.3 mungesa në punë për shkak të pushimit vjetor, pushimit mjekësor, festave dhe trajnimeve mbi pesë (5) ditë në muaj;
2.4 angazhimi në grupe punuese, komisione nga KGJK apo nga autoritete tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 16
Numri i lëndëve të vendosura në procedurë ankimore

1. Numri i lëndëve të shqyrtuara sipas mjeteve juridike në procedurë ankimore përdoret si tregues pas analizave të hollësishme të lëndëve përkatëse nga komisioni vlerësues.

2. Për qëllim të vlerësimit të performancës, lëndë të cilat janë vendosur sipas mjeteve juridike konsiderohen lëndët e vërtetuara dhe të ndryshuara, kurse lëndët e anuluara vlerësohen vetëm për shkak të shkeljeve esenciale.

3. Ky nen nuk është i zbatueshëm për gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

Neni 17
Përpilimi i vendimeve gjyqësore

Komisioni vlerësues do të marrë parasysh respektimin e afateve ligjore për hartimin e vendimeve gjyqësore.

Neni 18
Renditja e lëndëve për vendosje

1. Gjyqtari vendos lëndët e pranuara sipas arritjes së tyre në gjykatë, pa marrë parasysh peshën, rëndësinë dhe kompleksitetin e tyre, me përjashtim të lëndëve me përparësi ligjore për vendosje, strategjisë për reduktimin e lëndëve të vjetra si dhe vendimeve të KGJK-së.

2. Lëndët me përparësi ligjore të të njëjtës natyrë gjithashtu vendosen sipas ardhjes së tyre në gjykatë

Neni 19
Vlerësimi i renditjes së lëndëve për vendosje

Respektimi i renditjes së lëndëve për vendosje i nënshtrohet analizave të posaçme nga anëtari raportues i komisionit në konsultim me gjyqtarin dhe kryetarin e gjykatës për çdo lëndë ku ka pasur lëshime të mëdha apo të shpesh

KREU V

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS

Neni 20
Komisioni

KGJK themelon Komisionin për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve në përbërje prej trembëdhjetë (13) anëtarëve-gjyqtarë, duke përfshirë Kryetarin e Komisionit

1. Përbërja e Komisionit përfaqëson shkallshmërinë e sistemit gjyqësor ashtu që nga Gjykata Supreme caktohen pesë (5) gjyqtarë, nga Gjykata e Apelit caktohen katër (4) gjyqtarë dhe nga radhët e gjykatave themelore caktohen tre (3) gjyqtarë. Gjyqtarët e caktuar në Komision duhet të kenë së paku pesë (5) vite përvojë pune si gjyqtar nga lëmi civil dhe penal.

2. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve nuk mund të zgjedhën kryetaret e gjykatave dhe anëtarët e Këshillit.

3. KGJK me rastin e themelimit të Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve merr parasysh strukturën etnike dhe gjinore.

4. Mandati i anëtarëve është tre (3) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe te një (1) mandati shtesë.

5. Kompensimi i anëtarëve të Komisionit bëhet sipas Udhëzimit të KGjK për kompensimin e anëtarëve të KGJK-së.

6. Nën-komisioni i tre (3) gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Performancës, do të jenë përgjegjës për vlerësimin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Vlerësimi i performancës do të bëhet në bazë të procedurës së përcaktuar në nenin 23 të kësaj Rregulloreje.

Neni 21
Kryetari i Komisionit dhe kompetencat

1. Kryetari i Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve caktohet nga KGJK nga radhët e anëtarëve të KGJK-së, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.

2. Kryetari i komisionit ka këto kompetenca:

2.1 përgatit planin dhe organizon punën e komisionit,
2.2 thërret dhe udhëheq takimet e komisionit,
2.3 vendos lidhur me përjashtimin e vlerësuesve sipas kërkesës,
2.4 përgatitë raporte dhe jep rekomandime lidhur me punën e komisionit,
2.5 përfaqëson komisionin në takimet e ndryshme,
2.6 nënshkruan raportet përfundimtare për vlerësimin, si dhe
2.7 kryen punë tjera për funksionimin e këtij komisioni.

3. Kryetari i Komisionit nuk mund te caktohet si vlerësues.

Neni 22
Plani dhe organizimi vjetor i punës se Komisionit

1. Ne çdo fillim të vitit, Komisioni për vlerësim miraton planin vjetor te punës përmes së cilit bëhet organizimi dhe ndarja e punëve ndërmjet anëtarëve te Komisionit respektivisht vlerësuesve.

2. Pas përzgjedhjes me short te 1/3 te gjyqtareve nga ana e Këshillit, Komisioni bënë ndarjen e listës se gjyqtarëve ne mënyrë proporcionale për secilin vlerësues, ashtu që ndarja e punës të siguroj objektivitet dhe evitimin potencial të konfliktit të interesit.

3. Plani vjetor i punës miratohet më së voni deri më datën 20 janar të çdo viti.

Neni 23
Anëtari raportues i komisionit

1. Pasi që bëhet ndarja e gjyqtarëve të cilët do jenë subjekt vlerësimi nga ana e secilit vlerësues, anëtari raportues i komisionit bënë organizimin e punës se tij në atë mënyrë që brenda nëntë (9) muajve ne vijim të bëjë vlerësimin e gjithë gjyqtarëve për te cilët është ngarkuar me planin vjetor te punës.

2. Anëtari raportues i komisionit nga radhët e Gjykatës Supreme ngarkohet me punë për mbledhjen e informatave për gjyqtarët e të gjitha niveleve, anëtari raportues i komisionit nga radhët e Gjykatës së Apelit ngarkohet me punë për mbledhjen e informatave vetëm për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore, derisa anëtari raportues i komisionit nga radhët e gjykatave themelore ngarkohet me punë për mbledhjen e informatave vetëm për gjyqtarët e gjykatave themelore.
3. Organizmi i punës se anëtari raportues i komisionit nënkupton:
   3.1 njoftimin e gjyqtarit i cili është subjekt i vlerësimit menjëherë pas ndarjes së punëve sipas planit vjetor,
   3.2 njoftimin e kryetarit te gjykatës se gjyqtarit i cili është subjekt i vlerësimit menjëherë pas ndarjes se punëve sipas planit vjetor,
   3.3 kërkesat e parashtruara ndaj shërbimeve të ndryshme për dhënien e informacioneve të nevojshëm për vlerësim,
   3.4 marrja e informatave të nevojshme për qëllim monitorimi të seancave gjyqësore dhe trajnimeve eventuale, si dhe

3.5 çdo veprimtari tjetër e domosdoshme për një vlerësim objektiv dhe transparent.

4. Te dhënat për të dëshmuar performancën e gjyqtarit nuk mund te kërkohen më të vjetra se tre (3) vite nga viti kur bëhet vlerësimi i performancës.

5. Raporti i anëtari raportues i komisionit (i paraqitur si Shtojca 3 e kësaj Rregulloreje) dorëzohet te gjyqtari i cili është subjekt i vlerësimit për ndonjë koment apo vërejtjeje eventuale jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e pranimit.

6. Raporti i vlerësimit për secilin gjyqtar së bashku me komentet apo vërejtjet eventuale të gjyqtarit i dorëzohet kryetarit të komisionit jo më vonë se data 15 nëntor të secilit vit kalendarik.

7. Raporti i vlerësimit dorëzohet në Komision me të gjitha shkresat dhe të dhënat e mbledhura gjatë vlerësimit.

8. Nën-komisioni për Vlerësim të Performancës i paraqet gjetjet e tij Komisionit të Vlerësimit të Performancës, i cili vendosë për vlerësimin e performancës sipas paragrafit 7 të nenit 24 të kësaj rregulloreje.

9. Anëtarët e Nën-komisionit për Vlerësim të Performancës angazhohen edhe si anëtar individual raportues të Komisionit.

Neni 24
Seancat plenare te Komisionit

1. Pas pranimit të raporteve nga secili vlerësues, Kryetari thërret seancat plenare të Komisionit ku diskutohet mbi secilin raport veç e veç.

2. Anëtari raportues është përgjegjës për të raportuar përkitazi me raportet për gjyqtarët për të cilët ka qenë përgjegjës për vlerësimin.

3. Si rregull, fillimisht diskutohet vetëm për ato raporte që nuk ka vërejtje apo komente nga ana e gjyqtarit.

4. Ne raste kur ka vërejtje apo komente, në seancë plenare ftohet gjyqtari në fjalë për të paraqitur argumentet e tij përkitazi me raportin.

5. Komisioni bazuar në raportet e anëtarit raportues të komisionit dhe vendimit përfundimtar te Komisionit përgatit listën në bazë të notave të marra përgjatë vlerësimit të të gjithë gjyqtarëve, listë e cila do te shërbej si bazë për KGJK për avancim apo ulje në detyrë.

6. Në rast se vlerësimi i gjyqtari dëshmon qartazi performancën dukshëm të dobët që ndikon në mos efikasitetin e gjykatës prej nga vije dhe që nuk kalon shkallën prej 30 pikëve nga maksimumi i pikëve, atëherë Komisioni rekomandon shkarkimin e tij.

7. Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve vendos sipas rregullit në mënyrë konsensuale, përjashtimisht nëse ka kundërshtim mbi raportin e anëtarit raportues të komisionit

Komisioni vendos me shumicë votash. Në rast te rekomandimit për shkarkim, Komisioni vendos me 2/3 të të gjithë anëtarëve të Komisionit.

8. Takime e Komisionit janë të mbyllura dhe zhvillohen nëse se paku nëntë (9) anëtarë janë prezent.

Neni 25
Mbështetje administrative

1. SKGJK i ofron mbështetje administrative komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve.

2. Drejtori i SKGJK cakton sekretarin dhe zyrtarët tjerë në mbështetje të komisionit nga radhët e zyrtarëve të SKGJK-së.

KREU VI

RREGULLAT E PROCEDURËS DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 26
Inicimi i procedurës dhe materialet e vlerësimit

1. Sekretari i Komisionit së paku gjashtë (6) muaj para skadimi te mandatit fillestar njofton Kryetarin e Komisionit dhe gjyqtarin në lidhje fillimin e procedurës për vlerësimin e performancës se tij për qëllim të ri-emërimit.

2. Në rastet të vlerësimit të gjyqtarëve me mandat të përhershëm, Komisioni, respektivisht anëtari raportues e njofton gjyqtarin dhe kryetarin e gjykatës për inicimin e procedurës së vlerësimit. Me rastin e njoftimi të gjyqtarit, kërkon nga ai që të paraqesë nëntë (9) vendime gjyqësore sipas përzgjedhjes se tij, tre (3) nga secili vit i vlerësimit.

3. Përjashtimisht, dispozitat e këtij neni nuk vlejnë në rast të vlerësimit me qëllim të ngritjes në detyrë në rastet kur gjyqtarët që aplikojnë për ngritje në detyrë nuk iu kanë nënshtruar procedurës së vlerësimit tre (3) vitet e fundit.

Neni 27
Raporti i Kryetarit të gjykatës

1. Kryetari i gjykatës i paraqet anëtarit raportues të komisionit raport të përgjithshëm për secilin gjyqtar në gjykatën përkatëse brenda një (1) muaji nga marrja e njoftimit nga Anëtari Raportues i Komisionit për gjyqtarin/ët që janë në listën për vlerësim.

2. Ky raport i përgjithshëm duhet të përqendrohet tek aftësitë organizative të gjyqtarit, menaxhimi me lëndë, ballafaqimi me vendimmarrje, aftësitë komunikuese, dhe sjellja në zyre, afatet kohore për përpilimin e vendimeve.

3. Raporti i paraqitur në Shtojcën 4 të kësaj Rregullore do të përdoret për secilin raport të vlerësimit. Dokumentet përkatëse të përdorura për vlerësim duhet të bashkëngjiten.

Neni 28
Rregullat për zgjedhjen e rastësishme të vendimeve

1. KGJK-ja me rastin e përzgjedhjes me short te 1/3 të gjyqtarëve merr vendim edhe për zgjedhjen e rastësishme të vendimeve gjyqësore.

2. Anëtari raportues do të kërkojë nga Zyra Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve kopjet e vendimeve gjyqësore që korrespondojnë me numrin për zgjedhjen e rastësishme të vendimeve gjyqësore, por në asnjë rast më pak se pesë (5) vendime gjyqësorë për secilin vit të vlerësimit.

Neni 29
Raporti i Komisionit

1. Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve i dërgon KGJK-së raportin përmbledhës për vlerësimin e secilit gjyqtar bazuar në formën në aneks (Shtojca 5) si dhe ranglistën e gjyqtarëve sipas vlerësimit te kryer e cilai nuk do të jeët publike.

2. KGJK mund të kërkojë informata shtesë Komisionit përkitazi me rang listën por nuk mund te ndryshoje atë. KGJK duhet ta marrë për bazë në rast të shpalljes së vendeve të lira e plotësohen përmes procesit të ngritjes në detyrë.

3. Komisioni vlerësues rekomandon masa shtesë për përmirësimin e punës së gjyqtarëve në rastet kur gjyqtari vlerësohet me vlerësimin "dobët". Ne raste të tilla, gjyqtari vlerësohet edhe një herë jo më vonë se një (1) vit nga vlerësimi i fundit dhe nëse edhe me këtë vlerësim nuk ka performancë me të mirë dhe vijon të vlerësohet shkallën "dobët" i rekomandohet Këshillit shkarkimi i tij.

4. Në rastet kur vlerësimi i gjyqtarit rezulton me shkallën "mirë" atëherë Komisioni vlerësues rekomandon masa shtesë për përmirësimin e punës së gjyqtarëve mirëpo në këto raste vlerësimi pasues bëhet siç përcaktohet me ligj.

5. Për qëllim të paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni, masa shtesë nënkuptojnë, por që nuk kufizohen në, vijimin e trajnimeve obligative për menaxhimin e rasteve, përpilimin e vendimeve gjyqësore, kodin etik.

Neni 30
Kundërshtimet e gjyqtarit ndaj raportit te vlerësimit të Anëtarit raportues

1. Gjyqtari ka të drejtë t'i paraqesë kundërshtim Komisionit të vlerësimit ndaj raportit të Anëtarit raportues brenda shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të tij. Lidhur me kundërshtimin vendos Komisioni.

2. Gjyqtari po ashtu mund të kërkojë përjashtimin e anëtarit raportues nëse mendon se ka ndonjë konflikt interesi dhe në lidhje më këtë kërkesë vendos kryetari i Komisionit. Në rast se Kryetari i Komisionit gjen se ka bazë për konflikt interesi, atëherë bënë ndërrimin e anëtarëve raportues. Kërkesa për përjashtimin e anëtarit raportues behët jo më vonë se 15 ditë nga pranimi i njoftimit sipas nenit 23 parag. 3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 31
Konfidencialiteti

Përveç nëse nuk parashihet ndryshe me ligj ose rregullore, të gjitha të dhënat dhe informatat e mbledhura gjatë procesit vlerësues të performancës janë konfidenciale dhe nuk zbulohen.

KREU VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 32
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Gjyqtarët me mandat fillestar të cilët kanë të përfunduar Programin fillestar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pranë Institutit Gjyqësor nuk do të i nënshtrohen vlerësimit të parë përgjatë mandatit fillestar.

2. Gjyqtarët me mandat të përhershëm të cilët i janë nënshtruar vlerësimit në dy (2) vitet e fundit nuk do të përfshihen në listën e përgjithshme për zgjidhje me short derisa të kalon periudha tre (3) vjeçare për vlerësim të rregullt.

3. Komisioni për Vlerësim ka mandat të dizajnojë të gjitha mostrat e listuara si shtojca në këtë Rregullore dhe të cilat pas miratimit në Komision do të bëhen pjesë integrale e kësaj rregulloreje. Komisioni për Vlerësim duhet të miratojë këto mostra brenda 30 ditëve pas formimit të Komisionit.

4. Kjo Rregullore hyn në fuqi dhe do të fillojë së zbatuari nga 1 janari 2017.

5. Për qëllim të vlerësimit të kandidatëve që kanë konkurruar për ngritje në detyrë në Gjykatë të Apelit dhe Gjykatë Supreme zbatohet Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve e vitit 2012.

6. Përjashtimisht paragrafit 4 të këtij neni, dispozitat e Kreut të V-të të kësaj Rregulloreje janë të zbatueshme menjëherë me miratimin e kësaj Rregulloreje nga KGJK dhe nënshkrimin nga Kryesuesi i KGJK-së. KGjK themelon Komisioni për Vlerësim jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje,

7. Me hyrjen në fuqi te kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve e miratuar ne vitin 2012.

Prishtinë, më datë _____

Nehat Idrizi,

Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

RAPORTI I ANËTARIT RAPORTUES TE KOMISIONIT

PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQTARËVE

(shtojca 3 e Rregullores)

FORMULAR I VLERËSIMIT

INFORMATA TË PËRGJITHSHME- të dhënat per gjyqtarin në vlerësim

Emri dhe mbiemri: _____

Gjykata:_____

Departamenti-divizioni: _____

Pozita: _____

PJESA E I: Aktivitetet relevante

(Pjesëmarrja në trajnime, publikime shkencore,profesionale etj)

PJESA E II: KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteri numër 1

1. Njohuritë profesionale, kapaciteti për arsyetime ligjore, aftësitë dhe kapaciteti në analizimin e problemeve ligjore dhe aftësitë profesionale bazuar në rezulatet e karrieres së mëparshme, përfshirë pjesëmarrjen në format e organizuara në trajnimet ku është organizuar performanca;

1.1 Rezultatet nga vlerësimi i mëparshëm:

Periudha		Vlerësimi
Prej	Deri	

1.2. Numri i tërësishëm i lëndëve në punë gjatë tre(3) viteve të fundit?

_____

1.3. Përshkruaj numrin dhe llojin e lëmive me të cilat merret gjyqtari

☐ _____ ☐ _____

☐ _____ ☐ _____

☐ ---------- ☐ ----------

☐ ---------- ☐ ----------

1.4. Numri i lëndëve të zgjidhura sipas lëmive në tri vitet e fundit:

☐ _____ ☐ _____

☐ _____ ☐ _____

_____

1.5. Vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura

- *nga gjyqtari 9 vendime*
- *nga KGJK-ja 15 vendime*

_____

1.6. Numri i lëndëve me ankesë(Përcaktoje lëndën sipas lëmisë)?

_____

1.6.1 të vërtetuara _____

1.6.2 të ndryshuara _____

1.6.3 të prishura për shkak të shkeljeve esenciale _____

_____

Shkalla e realizimit të normës:

1.7. A e ka përmbushur gjyqtari normën sipas rregullores së KGJK-së, mbi normat?

_____

1.8.Kompleksiteti i lëndëve të kryera :**(neni 14 dhe 15 i Rregullores)**

*1.8.1 Lëndët e përfunduara me vendim për çështjen kryesore*_____

1.8.2 Lëndët e përfunduara me vendim procedural _____

Pikët për kriterin numër 1 _____

Kriteri numër 2. PERFORMANCA matet sipas kritereve në vijim:

2.1. Menaxhimi efikas i lëndëve;
2.2 .Data e pranimit të lëndës nga gjyqtari;
2.3. Trajtimi i lëndëve sipas rradhës (me përjashtim të lëndëve me prioritet ligjor dhe sipas Strategjisë së KGJK-së)
2.4. Menaxhimi i seancës gjyqësore;
2.5. Data e marrjes se vendimit;
2.6. Data e përpilimit të vendimit gjyqësor;
2.7. Dorëzimi i vendimit në shkrimore

Pikët për kriterin numër 2 _____

Kriteri numër 3 Përvoja e punës

Gjykata _____, departamenti_____
divizioni_____, vitet_____.

Pikët për kriterin numer 3 _____

Kriteri numër 4. Njohuritë dhe respektimi i të drejtave të njeriut

Respektimi i të drejtave të njeriut në proces gjyqësor në bazë të konventave ndërkombëtare dhe praktikës së GJEDNJ-së.

Pikët për kriterin numër 4 _____

Kriteri numër 5 Masat disiplinore

Masa disiplinore e shqiptuar nga Komisioni Disiplinor ose Këshilli Gjyqësor, për shkak të shkeljes se Kodit të Etikës së Gjyqtarëve.

5.1. Vendimmarrja transparente
5.2. Ballafaqimi me vendimet e domosdoshme
5.3. Debatimi dhe kritika konkrete

Pikët për kriterin numër 5 _____

Kriteri numër 6. Aftësitë Komunikuese

6.1. Dëgjimi aktiv dhe i drejtë i palëve dhe pjesëmarësve të tjerë në procedurë;
6.2. Shkëmbimi i përvojave.

Pikët për kriterin numër 6_____

Anëtari i Komisionit Vlerësues për të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë shtojcë, gjyqtarin, i cili i është nënshtruar vlerësimit të performancës për periudhën e kërkuar e vlerëson me:

_____pikë.

Emri dhe Mbiemri i anëtarit raportues

Datë, _____

Prishtinë, _____

Nënshkrimi

_____

Komentet shtesë të gjyqtarit raportues të Komisionit:

Vërejtje apo komente, gjyqtari i vlerësuar mund të bëjë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të raportit.

KESHILLË JURIDIKE:

Gjyqtari ka të drejtë të paraqes kundërshtim Komisionit të Vlerësimit ndaj raportit të anëtarit raportues, brenda 7 ditësh, nga dita e pranimit. (neni 30.1 i Rregullores).

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Raporti i kryetarit të gjykatës
(Shtojca 4)

PJESA I: INFORMATA TË PËRGJITHSHME- të dhënat per gjyqtarin në vlerësim

Emri dhe mbiemri: _____

Institucioni-_____

departamenti-divizioni: _____

Pozita: _____

PJESA II:

Aftësitë organizative të gjyqtarit, menaxhimin me lëndë, ballafaqimi me vendimmarrje, aftësitë komunikuese, sjellja në zyrë dhe afatet kohore për përpilimin e vendimeve.

1. Respektimi i standardeve të sjelljes brenda dhe jashtë zyrës për aq sa ka të bëjë me aktivitetin profesional të gjyqtarit

2. Respektimi i standardeve kohore sipas ligjit, për përpilimin e vendimeve



3. Aftësitë komunikuese (në raport me kolegët, stafin administrativ dhe palët)

4. Vetiniciativë, kreativitet

5. Gatishmëri për pjesëmarrje në grupet punuese profesionale, në edukim profesional dhe në trajnimet e rregullta

Raporti i përgjithshëm kryetarit të gjykatës dhe vërejtjet eventuale për gjyqtarin

(këtë raport kryetari duhet t'ia dërgojë, në afat prej një (1) muaji nga marrja e njoftimit, anëtarit raportues të komisionit, neni 27 i Rregullores)

Kryetari i gjykatës:
Data / Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Raporti përmbledhës i Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve-neni 29.1 i Rregullores (shtojca nr.5)

INFORMATA TË PËRGJITHSHME-

Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve që i'u kanë nënshtruar vlerësimit të performancës, me mandat të përhershëm dhe për riemërim: ____

Gjykata Supreme e Kosovës: ____

Gjykata e Apelit e Kosovës: ____

Gjykatat Themelore: ____

- Të përhershëm ____
- Për riemërim ____

1.Vlerësimi i gjyqtarëve sipas shkallëve në vijim prej 1-100 pikë:

1.1. Numri i gjyqtarëve të vlerësuar me 1 deri në 30 pikë, (dobët): ☐

1.2. Numri i gjyqtarëve te vlerësuar me 31 deri në 50 pikë, (mirë) ☐

1.3. Numri i gjyqtarëve të vlerësuar me 51 deri në 80 pikë, (shumë mirë): ☐

1.4. Numri i gjyqtarëve të vlerësuar me mbi 81 pikë, (shkëlqyeshëm): ☐

2. REKOMANDIMI I MASAVE SHTESË:

2.1. Komisioni për gjyqtarët e vlerësuar me 1 deri 30 pikë (dobët), rekomandon masat shtesë si në vijim:

- Vijimi i trajnimeve obligative për menaxhimin e rasteve;
- Përpilimi i vendimeve gjyqësore;
- Kodin Etik;
- Të tjera

Rivlerësimi i performancës së gjyqtarëve nga pika 2.1, do të bëhet jo më vonë se 1 (një) vit nga vlerësimi i fundit.

2.2. Komisioni për gjyqtarët e vlerësuar me 31 deri 50 pikë (mirë), rekomandon këto masa shtesë:

- Vijimi i trajnimeve obligative për menaxhimin e rasteve;
- Përpilimi i vendimeve gjyqësore;
- Kodi Etik;
- Të tjera.

Kryetari i Komisionit

Emri dhe Mbiemri / Nënshkrimi

_____ / _____ / _____

Anëtarët e Komisionit:

	Emri	**Mbiemri**	**Nënshkrimi**
1.	_____	_____	_____
2.	_____	_____	_____
3.	_____	_____	_____
4.	_____	_____	_____
5.	_____	_____	_____
6.	_____	_____	_____
7.	_____	_____	_____
8.	_____	_____	_____
9.	_____	_____	_____
10.	_____	_____	_____
11.	_____	_____	_____
12.	_____	_____	_____

Datë:

Prishtinë _____